

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më 08.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 3

DATË 26.08.2025 ORA 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026.

Marrin pjesë:

Kryetare e Bashkisë Vlorë znj. Brunilda Mersini, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Deputetja-znj. Zamira Sinaj, Kryetar i Rajonit 3- z.Elidon Jaho, Sekretare e Këshillit Bashkiak – znj. Launela Dautaj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxhaj, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.
(Në takim morrën pjesë 44 persona)

Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë- Znj. Brunilda Mersini: Duke përfutur edhe nga prania e deputetes, pasi edhe deputetët kanë axhendën e tyre politike, e cila shpesh nuk i lë të lirë, në opinionin tim, si kryetare bashkie, vëmendja duhet të jetë gjithmonë te shërbimi ndaj qytetarëve.

Rajoni 3 ka qenë në fokusin tonë gjatë vitit 2026, me disa investime të rëndësishme. E kam menduar fort edhe problemin që qyteti që vuan prej kohësh, furnizimin me ujë. Furnizimi me ujë është në kompetencë të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetësit, i takon Bashkisë, nga ana morale dhe politike, të mbajë përgjegjësi për furnizimin me ujë të qytetit.

Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Tel: 033421201; Fax 033421201: www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

Gjithsesi, kemi një projekt që besoj se gjatë muajit tetor do të ketë një lloj finalizimi të investimit. Por, pavarësisht kësaj, kemi menduar që problemet e ujësjellësit të mos e dëmtojnë më qytetin, sidomos sa i përket rrugëve dhe infrastrukturës. Edhe buxheti i vitit 2026 ka pasur një nivel të konsiderueshëm investimesh në asfaltim. Për Rajonin 3, besoj se e keni parë që jemi përpjekur, në një pjesë të madhe, përmes asfaltimit, në disa segmente të rëndësishme të qytetit.

Një tjetër problematikë janë shtesat e pallateve, të cilat sot ndikojnë në procesin e rikonstruksionit të fasadave. Vetë procesi i rikonstruksionit do të na detyrojë të kërkojmë prishjen e këtyre ndërtimeve. Janë mbi 32 objekte që preken nga i gjithë ky proces. Jemi detyruar të ndjekim edhe procesin e shpronësimit, i cili është një proces ligjor dhe kërkon kohën e vet. Për këtë arsye, rehabilitimi i të gjithë bllokut do të marrë kohë, por në fund shpresoj fort që të kemi një bllok të transformuar, ku të ketë edhe një treg ambulant për fruta dhe perime. Do të fillojmë me tregjet e lëvizshme kudo në qytet, me rreth 30 pika ambulante të instaluar. Do të ketë gjithashtu një kënd lojërash për fëmijët, me hapësira të dedikuara për grupmosha të ndryshme, si dhe një element shumë të rëndësishëm kemi parkimin. Duam të krijojmë hapësira parkimi, sado të vogla të jenë ato, dhe të fillojmë t'i sistemojmë në mënyrë të organizuar. Dua të ndalem edhe te një projekt tjetër i rëndësishëm. Në buxhetin e vitit 2027, nën kujdesin e veçantë të Kryeministrit, Vlora synon të jetë qyteti i parë që do të nisë transportin publik me autobusë elektrikë.

Është një projekt që, nën vëmendjen e tij, duhet ta bëjë Vlorën qytetin e parë në këtë drejtim. Ajo që kemi kërkuar është që autobusët të vijnë në formate të ndryshme, pasi në disa raste edhe madhësia e autobusëve është bërë problem për trafikun. Pa diskutim, bashkë me furnizimin me autobusë të rinj, do të përmirësojmë tërësisht edhe linjat e transportit publik në qytet. Në këtë kuadër, kemi përfshirë në buxhetin e vitit 2027 hapjen e segmentit nga Shkallët te ish tregu Orizit, si dhe rrugën e shkollës "Ismail Qemali". Të dyja këto janë projekte të hartuara nga Bashkia e Vlorës dhe të përfshira në propozimin për buxhetin e vitit 2027.


Jemi duke menduar që transporti publik, së bashku me stacionin terminal, të cilin e kemi planifikuar ta fillojmë si projekt në vitin 2027, të jetë një ndër veprat e mëdha infrastrukturore të qytetit. Implementimi i tij do të kërkojë kohën e vet, por kemi menduar që ta fillojmë si projekt terminalin e autobusëve.

Edhe parkimi në Skelë, pranë universitetit, është një vepër publike që do të ofrojë rreth 250 vende parkimi, si dhe hapësira për shërbime publike, përfshirë banjot publike. Shumë shpejt fillon edhe rikonstruksioni i Shkollës së Muzikës. Do të tentojmë fort që ta kthejmë në një shkollë rajonale për të gjithë jugun e vendit, duke qenë se kemi modele shumë të mira dhe një potencial të madh në këtë drejtim.

Rikonstruksioni është menduar jo vetëm për përmirësimin e kushteve të mësimin, por edhe për ta bërë shkollën më të aksesueshme gjatë orëve të pasdites, në mënyrë që nxënësit dhe të gjithë ata që duan të zhvillojnë talentet e tyre të kenë mundësi të ushtrohen dhe të përfitojnë nga kjo hapësirë. Edhe këndi i lojërave të "Tre Racat" mendoj se ka pasur një impakt të madh te fëmijët.

Mendoj se të tilla hapësira duhet të krijohen në çdo lagje të Vlorës. Kemi filluar edhe të shkolla “Marigo Posio”, në lagjen Çole, ku kemi ndërtuar një kënd lojërash.

Në këtë drejtim, mendoj se buxheti i vitit 2027 duhet të jetë më i vëmendshëm edhe ndaj njësive administrative. Për shumë vite kemi pasur një ndarje jo të drejtë të buxhetit. I kemi dhënë gjithmonë më shumë frymë qytetit, por nuk u kemi dhënë njësive administrative aq sa duhet. Fillon rikonstruksioni i Çerdhes nr. 15, fillon rikonstruksioni i Kopshtit nr. 1, të cilat mund të mos jenë pjesë e Rajonit 3, por janë investime shumë të rëndësishme për qytetin. Fillon gjithashtu rikonstruksioni i Kopshtit nr. 9, i cili është pjesë e bllokut tuaj, dhe do të vazhdojmë me rikonstruksimin e të gjithë kopshteve dhe çerdheve të qytetit. Shpresojmë që, pavarësisht se nuk janë të gjitha pjesë e Rajonit 3, investime të tilla si Kopshti nr. 13 dhe Kopshti “Sulo Didë”, ky i fundit që prek edhe rajonin tuaj, të jenë pjesë e një programi të vazhdueshëm për përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe sociale në të gjithë Vlorën.



Banor: - Shtesa është ndërtuar në vitin 1991, pranë tregut “Orizi”. Kemi frikë se mund të mbetemi pa strehë.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Shtëpia bazë nuk preket, ndërhyrja do të jetë vetëm në shtesat e ndërtuara jashtë saj. Këto shtesa po dëmtojnë fasadën dhe soletën e pallatit, duke krijuar rrezik për banorët e kateve të tjera. Një shembull konkret është rasti i rrjedhjeve të ujit nga bojlerët, të cilat kanë shkaktuar probleme edhe në katin e pestë. Për banorët parashikohen tre alternative, kompensim financiar për shpenzimet, sistemim në banesë sociale, bonus qiraje. Në këtë rast mund të sjellim si shembull edhe situatën e krijuar në

gjurmën e kanalit të “Naunkës”, ku janë prishur ose do të prishen rreth 15 objekte të ndërtuara mbi kanalin e ujërave. Një prej banoreve pranoi prishjen e objektit të saj, duke e kuptuar nevojën për të shmangur rrezikun e përmbytjes së gjithë lagjes. Qëllimi është të gjendet një zgjidhje që mbron banorët, interesin e komunitetit, duke ofruar njëkohësisht alternativa konkrete për familjet e prekura.

Banor: - Jetoj në një dhomë me kuzhinë 50 m² total, ndarë mes prindërve dhe djalit. Shtesa është rreth 1 metër është mbi tokë publike/të shtetit.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: - Apliko për bonus qiraje ose banesë sociale, fillo menjëherë përgatitjen e dokumentacionit pasi prishjet fillojnë brenda një muaji.

Banor: - Cila është lidhja midis shtesës dhe fasadës së pallatit?

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: Vendimi bazohet në projektin e miratuar nga Bashkia, të firmosur nga shtatë inxhinierë të fushave përkatëse të cilët kanë kërkuar heqjen e shtesave dhe lirim të trotuareve dhe segmentit të rrugës.

Banor: - Paguajmë taksën e pastrimit, por hyrjet e pallateve mbeten të palara.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: - Pastrimi i hyrjeve të pallateve, korridoreve të brendshme është përgjegjësi e administratorit të pallatit, jo e bashkisë.

Banor: - Rregullimi dhe rehabilitimi i “Rrugës së Çajupit”, e cila aktualisht nuk ka hyrje-dalje funksionale në zonë, ndonëse dikur lidhej me bulevardin dhe rrugën transballkanike. Gjithashtu, kërkohet vendosja e tabelave orientuese, krijimi i një parku lojërash për fëmijë dhe sistemimi i një hapësire të përshtatshme për të moshuarit.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: - Kemi përcaktuar prioritetet e Rajonit 3 për vitin 2027: fillimisht blloku i “Salatit”, më i amortizuari dhe aktualisht në fazën e projektimit; më pas blloku i “Kombinatit”, ku evidentohen problematika të theksuara sa i përket pastrimit, të cilat, sipas saj, lidhen me praninë e banorëve të ardhur.

Banor: - Vlerësoj pozitivisht përmirësimet e bëra në qytet, veçanërisht sa i përket pastrimit, sistemimit të shesheve dhe përmirësimit të ndriçimit. Problem janë disiplinimi i qarkullimit dhe parkimit në bllok. Kërkojmë vendosjen e një sinjalistike të qartë për drejtimin e lëvizjes (kthim majtas/djathtas), pasi mungesa e disiplinës në qarkullim po krijon rrezik për këmbësorët. Krijimi i një rruge të re lidhëse mes bllokut dhe “Rrugës së Çipave”.

Banor: - Kritikë ndaj gjendjes së parkut, zonës pranë Shtëpisë së Pavarësisë, kinemaja verore jofunksionale. Kërkesë për më shumë promovim të artistëve, produkteve kulturore vendase në aktivitetet e sezonit turistik, në vend të artistëve të huaj të shtrenjtë.

Kryetare e Bashkisë Vlorë-znj. Brunilda Mersini: - Gjate sezonit veror kemi patur dhe aktivitete ku në fokus kanë qenë artistë shqiptarë, si dhe kemi bërë financim të koncerteve të nxënësve të shkollës së muzikës, qendrës kulturore.

Deputete-znj. Zamira Sinaj: - Ju Falenderoj të gjithëve për praninë fokusi zyrtar i takimit ishte buxheti i vitit 2027 dhe jo trajtimi i problematikave individuale të ndërtimit. theksoi se këto çështje po trajtohen veçmas nga kryetarja e bashkisë dhe stafi i saj, ndërsa Elidoni do të jetë personi i kontaktit për problematikat individuale në terren. Theksoi se problematikat e evidentuara aktualisht janë në një masë të konsiderueshme pasojë e 30 viteve abuzim me hapësirat publike, çka ka krijuar një situatë komplekse që kërkon kohë dhe bashkëpunim për t'u adresuar.

Shpreh mirënjohjen ndaj kryetares së bashkisë dhe stafit për angazhimin dhe punën e bërë brenda një periudhe të shkurtër kohore, duke kërkuar nga banorët durim, mirëkuptim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm në vijim.

Faleminderit!

Konceptoi:
Aurora Kamberaj
Koordinatore për Njoftim dhe Konsultim Publik

